



Komuna e Fushë Kosovës



Empowered lives.
Resilient nations.

Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë - PRAK, në kuadër të Projektit ‘Ngritja e kapaciteteve për vet-menaxhim të shëndetit’ që realizohet në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD 2), i financuar nga Bashkimi Evropian dhe që zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM për pozitën:

1. Stomatolog/e
2. Mjek/e familjar

Rreth organizatës PRAK

Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK) është Organizatë Jo-Qeveritare e themeluar në janar 2013 si mekanizëm i nevojshëm për avokim në mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në Kosovë. PRAK synon fuqizimin e rolit të pacientëve brenda sistemit të kujdesit shëndetësor, si dhe rolin e tyre në përgjithësi në Kosovë, si një parakusht për një reformë të suksesshme në shëndetësi.

Përmbledhje e projektit

Projekti “Ngritja e kapaciteteve për vet-menaxhim të shëndetit” ka për qëllim rritjen e mbrojtjes së nxënësve nga rreziqet shëndetësore dhe shkeljes së të drejtave të tyre në kujdesin shëndetësor përmes edukimit shëndetësor dhe mënyrës së shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore.

Ne jemi duke kërkuar Trajnerë për angazhim në Komunën e Fushë Kosovës

Përgjegjësit kryesore për Trajner/e për stomatologji,

- Të hartojë Modulin e trajnimit rreth higjienës orale dhe asaj të duarve;
- Të zhvilloj trajnime për nxënësit e klasëve të 5-ta rreth higjienës orale dhe asaj të duarve;
- Kupton dhe i respekton procedurat e komunikimit, udhëzimet dhe politikat e OJQ-së;
- Përshtatet në punë ekipore dhe
- T’i raportoj direkt Menaxherit të projektit.

Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Implementuar nga:





Komuna e Fushë Kosovës



Empowered lives.
Resilient nations.

Përgjegjësit kryesore për Trajner/e për mjek/e familjar:

- Të hartojë Modulin e Trajnimit për urgjencat mjekësore;
- Të zhvilloj trajnime për stafin arsimor rreth urgjencave që mund të kenë fëmijët brenda institucioneve arsimore;
- Kupton dhe i respekton procedurat e komunikimit, udhëzimet dhe politikat e OJQ-së;
- Përshtatet në punë ekipore dhe
- T'i raportoj direkt Menaxherit të projektit.

Kualifikimet e kërkuara për stomatolog:

- Të ketë të përfunduar fakultetin e stomatologjisë;
- Të ketë përvojë paraprake në edukim të komunitetit;
- Entuziazëm për të punuar me mosha të reja;
- Aftësi të mira të komunikimit;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve lokale është përparësi

Kualifikimet e kërkuara për mjekë të mjekësisë familjare:

- Të jet specialist/e i/e mjekësisë familjare me përvojë pune të paktën 1 vit në shërbimin urgjent;
- Të ketë përvojë paraprake në edukim të komunitetit dhe në urgjenca mjekësore;
- Aftësi të mira të komunikimit;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve lokale është përparësi.

Organizata jonë do të ofrojë:

- Organizim të trajnimeve për nxënësit e klasave të 5-ta dhe organizim të trajnimeve për stafin arsimor;
- Pajisje të nevojshme për realizimin e trajnimeve Projektor, Llaptop dhe pajisje të tjera të nevojshme;
- Pagë konkurruese (deri në 25.00 € për një orë).

Të gjithë kandidatët e kualifikuar do të konsiderohen për punësim në organizatën tonë pa dallim race, ngjyre, besimi apo gjinie.

Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Implementuar nga:





Komuna e Fushë Kosovës



Empowered lives.
Resilient nations.

Si të aplikoj?

Kandidatët që e shohin veten si të përshtatshëm për këtë pozitë dhe që mendojnë se do të kontribuonin dhe besonin në kulturën e organizatës janë të inkurajuar të aplikojnë. Aplikuesit duhet të dërgojnë **CV-në** e përditësuar në e-mail adresën info@prak-kosova.org me subjekt **“Trajner”**,

Data e fundit për aplikim është **10.11.2022, ora 16:00**. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

I mirëpresim aplikacionet e juaja!

Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Implementuar nga:

